



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI**

Në bazë të neneve 12.2 shkronja d dhe 17 shkronja s, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2013 për Transparencë në Komuna, neneve 15.2 shkronja d dhe 19 shkronja s, të Statutit të Komunës, nr. 01-1/298-10, dhe neneve 3 dhe 49 të Rregullores nr. 01/18-02 për mënyrat, procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2015, mori,

### **VENDIM PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMUNALE PËR INFORMIM DHE KOMUNIKIM 2015-2018**

#### **Neni 1**

Miratohet Strategjia Komunale për Informim dhe Komunikim për periudhën 2015-2018.

#### **Neni 2**

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Strategjia Komunale për Informim dhe Komunikim 2015-2018.

#### **Neni 3**

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

**Nr. 01-006-44954**  
**Podujevë,**  
**30 prill 2015**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Mehmet Gashi**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

***STRATEGJIA KOMUNALE PËR  
INFORMIM DHE KOMUNIKIM  
2015-2018***

Podujevë  
2015

# Projekti i mbështetur nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)

## Përmbajtja

### Çka është strategjia

Fjalorthi i shkurtesave.....  
Akte të interesit.....  
Grupet e synuara / përfituesit .....

## PJESA E PARË

Hyrja.....  
Detyrimet ligjore për hartimin strategjisë.....  
Strategjia është i hartuar mbi tri baza kryesore.....

## PJESA E DYTË

Vizioni dhe objektivat.....  
Objektivat, prioritetet e strategjisë .....

SWOT ANALIZA.....

## PJESA E TRETË

Analiza e gjendjes së informimit dhe komunikimit.....

## PJESA E KATËRT

Plani dinamik.....  
Objektivi i parë: Përmirësimi mënyrave të informimit për qytetar.....  
Objektivi i dytë: Krijimi i mënyrave për ndikimin e qytetareve ne politikat publike...

## PJESA E PESTË

Buxheti .....

Plani i monitorimit dhe zbatimit .....

## Fjalorthi i shkurtesave

- KK-Kuvendi i Komunës
- KPF- Komiteti për Politikë dhe Financa
- ZMPI- Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim
- GP-Grupi punues
- BL-Bashkësitë Lokale
- OSBE-ja-Organizata për Siguri, Bashkëpunim në Evropë
- BE – Bashkimi Evropian

## **Akterët dhe palët e interesit**

Ky projekt financohet dhe implementohet nga Komuna e Podujevës.  
Kordinator i Komunës për Strategjinë për Informim dhe Komunikim është  
Nazmi Elezi- shef i Zyrës për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim

## **Grupi Punues:**

1. Mehmet Gashi - Kryesues i Kuvendit të Komunës
2. Nazmi Elezi- shef i Zyrës për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim
3. Bujar Gimolli - Zyrtar për Informim Publik
4. Enis Sheholli - Zyrtar në Zyrën Ligjore
5. Fatlume Jaha – këshilltare e Kuvendit të Komunës
6. Fjolla Besholli – KVRL – Podujevë

## **Grupet e synuara / përfituesit**

Grupet strategjike të synuara përmes kësaj Strategjie janë: qytetarët (publiku) mediat (lokale dhe nacionale), studentët, nxënësit e shkollave, organizatat e shoqërisë civile, shoqata të bizneseve dhe grupet e marginalizuara të shoqërisë.

## **Çka është strategjia**

Strategjia është një plan i hartuar për të arritur një qëllim. Institucionet, organizatat, shoqatat dhe kompanitë hartojnë strategji, që të paraqesin vizionin e tyre dhe objektivat. Kjo Strategji është shoqëruar me udhëzime operative më: objektivat, prioritet, aktivitete konkrete, rezultate të pritshme, buxhetin dhe monitorimin.

Pjesë përbërë e strategjisë është plani i veprimit për hartim, plani dinamik dhe plani i monitorimit, të cilat përbëjnë mjetet e rëndësishme për veprim nga teoria në praktike. Në praktikë këta hapa do të nxisin miratimin e praktikave të standardizuara dhe shkëmbimin e informacionit të ndërsjellët në mes Komunës dhe qytetarit.

## PJESA E PARË

### Hyrja

Strategjia për Informim dhe Komunikim, është dokument i rëndësishë së veçantë për Komunën e Podujevës, e cili rregullon fushën e komunikimit dhe informimit në relacionin qytetar - Komunë.

Strategjia është një përpjekje për të avancuar komunikimin mes Komunës dhe qytetarit.

Qëllimi i Strategjisë është inkurajimi për pjesëmarrjen aktive të qytetareve në aktivitete komunale, si dhe ndërtimi urave lidhëse në mes të këtyre dy akterëve për të forcuar lidhjen, me synim për ngritje të besimit tek pushteti lokal.

Hartimi i Strategjisë ka për qëllim që të vë në zbatim planet konkrete për të inkurajuar dhe nxitur pjesëmarrjen e qytetareve në vendimmarrje. Krijimi i kësaj lidhjeje me qytetarët e vë Komunën përballë vështirësive për gjetjen e mënyrës, rrugës, qasjes më të lehtë apo më të përshtatshme për të komunikuar dhe informuar qytetarin.

Kjo Strategji komunikimi dhe informimi, do të jetë një ndihmesë për punën e Komunës e cila fokusohet në rritjen e transparencës komunale përmes ofrimit efektiv të informacionit dhe avancimit të mjeteve të komunikimit me qëllim të marrjes së mendimit të qytetarit për çështje që ndikojnë në përmirësimin e kualitetit të jetës së banorëve të Komunës së Podujevës.

Komuna e Podujevës, nëpërmjet këtij dokumentit strategjik planifikon të ofrojë kushte të një qeverisjeje të mirëfilltë lokale, me një shoqëri aktive e cila merr pjesë dhe përgjegjësi në avancimin e çështjeve komunale.

Për realizimin e objektivit të lartpërmendur, Komuna do të bashkëpunojë ngushtë me qytetarët përmes takimeve të drejtpërdrejta, mediave të shkruara dhe elektronike, ueb faqes, rrjeteve sociale (Facebook, YouTube etj).

Dokumenti i Strategjisë është strukturuar në dy pjesë ku pjesa parë është tekst narrativ dhe pjesa e dytë përfshin planin e veprimit, zbatimit dhe monitorimit të Strategjisë.

Metodologjia e përdorur për hartimin e Strategjisë është hulumtimi i gjendjes ekzistuese rreth informimit dhe komunikimit, konsultimeve me grupet e ndryshme brenda dhe jashtë institucionit të Komunës së Podujevës si dhe krijimi mekanizmave që mundësojnë fuqizimin e zërit të qytetarit në procesin e vendimmarrjes.

### **Kuadri ligjor & rregullativ për hartimin strategjisë**

Në të gjithë kapitujt e Strategjisë shqyrtohen disa aspekte aktuale në fushën e informimit dhe komunikimit. Ky dokument është hartuar në përputhshmëri me strukturën institucionale ligjore të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit mbi Qasje në Dokumentet Publike, Statutit të Komunës si dhe akteve të tjera normative lokale.

Kjo Strategji është në përputhje me kriteret e aquis komunitare të Bashkimit Evropian, të cilat parashohin shkallë më të lartë të efikasitetit në fushën e informimit dhe komunikimit. Strategjia, përbën kornizën e përbashkët për të gjithë akterët ndërmjet Komunës me qytetarin, shoqërinë civile, mjetet e informimit me synim që të arrihen mënyra të shumta të komunikimit.

Komuna e Podujevës e ka të miratuar Rregulloren për Transparencën e punës të Institucioneve të Komunës së Podujevës, e cila qartëson detyrat dhe përgjegjësitë e organeve komunale ndaj qytetarëve. Për hartimin e draftit të parë të kësaj Strategjie për Informim dhe Komunikim, është formuar grupi punues i përbërë nga zyrtarë komunal, shoqëria civile dhe përfaqësues të tjerë.

Strategjia për informim dhe komunikim është shqyrtuar në Kuvendin e Komunës, është vënë në diskutim publik me qytetarët dhe njëjta është miratuar në Kuvend.

## **Strategjia është i hartuar mbi tri baza kryesore**

### **1. Analiza e gjendjes në fushën e informimit dhe komunikimit**

Analiza e gjendjes në fushën e informimit dhe komunikimit paraqet mekanizmat lokal ekzistues, të cilat me kalimin e kohës duhet të ndryshohen përkatësisht të përmirësohen me synim të përmirësimit të komunikimit me qytetarë. Këta mekanizma në nivel lokal parashikojnë mundësi për përfshirjen e mëtejme të qytetarëve në funksionimin e Komunës në mënyrë që qytetarët të jenë subjekt dhe pjesëmarrës aktivë në vendimmarrje. Dokumenti i tillë strategjik është arritur përmes analizave të gjendjes ekzistuese, përmes hulumtimit të dhënave në dispozicion, takimeve me qytetarët/grupet tjera.

### **2. Plani i veprimit**

Në planin e veprimit në mënyrë të detajuar janë dhënë prioritet me aktivitetet përkatëse, të cilat përcaktojnë kohën e përmirësimit të komunikimit me linja buxhetore. Ky plan i zhvillimit të veprimit ka paraqitur kornizën kohore, aktivitetet dhe personat përgjegjës për zbatimin e atyre aktiviteteve. Plani i veprimit do t'i mundësojë ekipit që ta masë përparimin e tij dhe ta mbajë përqendrimin në detyrat e rëndësishme.

### **3. Plani i monitorimit**

Në bazë të objektivave strategjike, prioriteteve, masave dhe projekteve specifike, është bërë përlllogaritja e përafërt buxhetore për secilin projekt si dhe afati kohor për zbatim. Si akter kryesor për zbatim të Strategjisë është Drejtoria e Administratës, kurse Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim (ZMPI), do të përkujdeset për monitorimin e zbatimit të dokumentit strategjik.

## PJESA E DYTË

### **Vizioni**

Komuna e Podujevës në periudhën e ardhshme tri vjeçare, ka për qëllim informimin dhe komunikimin efektiv më qytetarët, me synim që t'u përgjigjet nevojave (interesave) të tyre.

### **Objektivi i parë**

Krijimi i mënyrave efektive për komunikim.

### **Objektivi i dytë**

Krijimi i komunikimit efektiv dhe ndikimi i qytetarëve në politikat publike.

### **Objektivi i tretë**

Krijimi kushteve të favorshme për pjesëmarrje aktive të qytetarëve.

### Prioriteti i parë

Komunikim efektiv në relacionin qytetar - Komunë, në mënyrë që aktivitetet dhe shërbimet komunale të jenë sa më afër qytetarit.

### Prioriteti i dytë

Qytetari të jetë pjesë e vendimmarrjes në Komunë, përmes propozimeve dhe ideve nga vetë ata.

### Prioriteti i tretë

Angazhimi i qytetarëve dhe shoqërisë civile në grupe të ndryshme punuese në nxjerrjen dhe miratimin e dokumenteve të rëndësishme.

## SWOT ANALIZA

### Përparësitë

- Komuna tashmë ka mënyrë të organizuar për informimin e qytetarëve – Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim;
- Mënyra e zhvilluar e informimit përmes rrjeteve sociale (ueb faqes zyrtare, Facebook, YouTube);
- Mënyra e informimit përmes buletinit mujor, tabelave informuese, monitorit, fletëpalosjeve, njoftimeve në media lokale;
- Takimet me publikun në Komunë dhe në zonat rurale.

### Dobësitë

- Interesimi i pamjaftueshëm i qytetarëve në të drejtën për qasje në dokumente publike
- Mungesa e tabelave informuese në zonat rurale
- Mungesa e komunikimit të drejtpërdrejtë (telefon për qytetarët).

### Mundësitë

- Përvoja dhe qasja profesionale në fushën e informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse;
- Korniza ligjore dhe normative e përshtatshme për informim, komunikim dhe pjesëmarrje të qytetarëve në proceset vendimmarrëse;
- Ligji për qasje në dokumente publike;
- Gatishmëria e qytetarëve në ndërtimin e partneritetit me Komunën (në sektorin e zhvillimit ekonomik, investimeve kapitale ) etj.

### Rreziqet

- Mungesa e linjës buxhetore e burimeve financiare për një zhvillim të avancuar të sistemit të informimit, komunikimit me publikun
- Mungesa e televizionit dhe të një gazete lokale
- Përkushtimi i pamjaftueshëm i OJQ-ve lidhur me fushën e informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjen e qytetarëve;

## PJESA E TRETË

### Analiza e gjendjes së informimit dhe komunikimit

Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim (ZMPI), që nga themelimi i është angazhuar dhe përkujdesur që të sigurojë informim korrekt dhe të shpejtë dhe ka siguruar marrëdhënie të mira me qytetarin, duke siguruar informim për të gjitha bashkësitë dhe qytetarët nga Komuna mbi çështjet përkatëse dhe anasjelltas. Kjo zyrë funksionon në kudër të zyrës së Kryetarit të Komunës dhe udhëhiqet nga shefi i Zyrës për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim (ZMPI), e në kuadër të saj janë edhe dy zyrtarë. ZMPI ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- I ofron publikut informata të rregullta përmes mediave.
- Organizon kontakte të rregullta më masmedia, konferenca për shtyp në baza periodike, lëshon njoftime dhe komunikata për shtyp.
- Bashkërendon kontaktet në mes të zyrtarëve të Komunës dhe mediave
- Përpilon dhe mirëmban faqen zyrtare të internetit të Komunës (ueb faqen). Aty plason informata mbi aktivitetet komunale, raportet, kalendarin e takimeve, regjistrin e numrave të telefonit dhe informatat kontaktuese të zyrtareve komunal (përgjegjës)
- Bashkërendon punën me Kryetarin e Komunës, Drejtoritë komunale dhe miraton dokumentet e ndryshme (broshurat dhe afisjet për qytetarë rreth shërbimeve ngjarjeve komunale).
- Siguron mbulimin e shtypit (lajmërimet për mbajtjen e takimeve, informatat mbi vendimet që janë marrë) në të gjitha ngjarjet, sikurse janë takimet dhe aktivitetet e Kuvendit Komunal, Kryetarit të Komunës, drejtorëve të Drejtorive, dhe Komiteteve të Kuvendit.
- Përcjell peticionet publike dhe kërkesat për informata mbi aktivitete komunale.
- I jep mbështetje aktive Kuvendit Komunal, Kryetarit të Komunës, drejtorëve të Drejtorive komunale, dhe komiteteve të Kuvendit, në koordinimin, organizimin, zbatimin dhe prezantimin në terren të aktiviteteve komunale.

Gjithashtu, ZMPI, në veçanti zyrtari-ja për informim bashkëpunon dhe mban kontakte me zyrtarët komunalë për informim në tërë rajonin dhe palët tjera të interesuara në punët kyçe komunale. Siguron informim përkatës për të gjitha bashkësitë dhe qytetarët (p.sh edhe ata në viset rurale të Komunës) nga Komuna. Nis dhe mbështet fushatat e mediave për çështjet përkatëse komunale, kurdo që kjo kërkohet. Arkivon fotografi, raporte, komunikata për shtyp, etj.

Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, informon dhe pasqyron në vazhdimësi aktivitetet e zhvilluara në gjithë territorin e Komunës. Plasimi me kohë dhe gjithëpërfshirës i informacioneve ka bërë që Komuna jonë të radhitet në mesin e komunave me transparencë të mirë.

Për të gjitha aktivitetet që zhvillohen në Komunë, duke përfshirë aktivitetet e Kuvendit të Komunës me trupat e tij punues, Kryetarit të Komunës dhe Drejtorive (zyrtarët komunalë), qytetari njoftohet nëpërmjet ZMPI, përmes:

- ✓ Ueb faqes zyrtare
- ✓ Facebook-ut
- ✓ Buletinit mujor
- ✓ Tabelës së njoftimeve,
- ✓ Monitorit,
- ✓ Kumtesave për media

Falë stafit të kompletuar, shefit të zyrës dhe dy zyrtarëve, ZMPI, përcjell dhe pasqyron të gjitha aktivitetet që zhvillohen brenda Komunës dhe në teren.

Në zbatimin e kësaj Strategjie, ZMPI do të përdorë një numër të caktuar mesazhesh (porosish) për të komunikuar qytetarit informacionin. Komuna, si pjesë e zbatimit të Strategjisë për informim dhe komunikim, do të shërbehet me këto mesazhe (porosi) me qëllim që:

- Komuna të jetë më afër qytetarëve,
- Të forcohet lidhja e qytetarëve me shërbimet komunale,
- Qytetarët të jenë pjesë e sistemit vendimmarrës,
- Komunikim të përhershëm me qytetarëve përmes mjeteve të komunikimit (ueb faqja, facebook-u, buletini, njoftimet dhe komunikatat në tabelën e njoftimeve, dhe debatet e drejtpërdrejta)

Në kuadër të ZMPI vepron edhe ueb faqja e Komunës, e cila u mundëson qasje të lehtë dhe informim të shpejtë qytetarëve dhe opinionit të gjerë për aktivitetet e zhvilluara. Ajo mundëson edhe qasje në dokumentet dhe publikimet e tjera të rëndësishme. Postimi i vazhdueshëm i dokumenteve dhe informatave të rëndësishme, që janë në interes të qytetarëve të Komunës së Podujevës ka ngritur transparencën e organeve komunale.

Rol të rëndësishëm në informim dhe komunikim më qytetarët dhe opinionin e gjerë, përveç ueb faqes kanë edhe rrjetet sociale. Komuna e Podujevës, posedon faqen zyrtare në rrjetin social Facebook, ku plasohen të gjitha informacionet.

Krahas formës elektronike, ueb faqes dhe Facebook-ut, ZMPI plasojnë informacionet për aktivitetet e Komunës edhe përmes buletinit mujor, i cili vendoset në vitrinën e vendosur në holin e Komunës, e cila u shpërndahet falas qytetarëve, ZMPI nxjerr edhe broshura vjetore të cilat përmbledhin kryesisht projektet kapitale të realizuara brenda vitit kalendarik.

Aktivitetet e Komunës përcillen edhe nga mediat e shkruara, përmes korrespondentëve të tyre, të cilët për aktivitetet që zhvillohen në Komunë shfrytëzojnë si burim të informatës dhe komunikimit ZMPI. Në Komunën e Podujevës funksionojnë dy media lokale, “Radio Vizioni” dhe “Radio Llapi”, të cilat janë një mjet i mirë dhe i shpejt informimi për qytetarët e Komunës, për aktivitetet dhe vendimet që merren në Komunën e Podujevës.

Përveç mënyrave të qasjes apo përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje nëpërmjet formave të përmendura, Komuna mban takime me qytetarë në formë të debateve dhe dëgjimeve publike si dhe bashkëpunim me qytetarët apo partneritet për realizimin e projekteve me interes të përgjithshëm.

## PJESA E KATËRT

### Objektivat dhe projektet

Strategjia për informim dhe komunikim ka tre objektiva kryesore:

*Objektivi 1:* Krijimi i mënyrave efektive për komunikim

Me këtë objektiv, Komuna e Podujevës synon të lehtësojë dhe avansojë komunikimin me qytetarët duke ofruar qasje më të mira për shërbimet në Administratën Komunale, nëpërmjet publikimit të formulareve online, po ashtu edhe duke ofruar informacione për aktivitetet e zhvilluara në Komunë.

Objektivat strategjik	Prioritet	Masat
<b>Objektivi 1</b>  <b>Krijimi i mënyrave efektive për komunikim</b>	<b>Prioriteti 1</b>  Komunikim efikas, me qëllim që shërbimet komunale të jenë sa më afër qytetarit	<b>Masa 1:</b> Kuvendi dhe trupat e tij, drejtoritë komunale përmes zyrtarëve të tyre, ofrojnë informacione për shërbimet komunale tek Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, në mënyrë që ato shërbime të prezantohen në ueb faqe dhe facebook të Komunës (aplikacionet online) etj.
		<b>Masa 2:</b> Drejtoritë e Komunës ofrojnë informacione tek ZMPI për iniciativat, aktivitetet për investimet kapitale, zhvillimin ekonomik, administratën, buxhetin dhe financat, arsimin, shëndetësinë gjithashtu edhe për aktivitetet të përbashkëta më organizatat joqeveritare etj.
		<b>Masa 3:</b> Drejtorët komunalë, përmes një zyrtari të autorizuar brenda Drejtorisë, ofrojnë informata tek ZMPI për aktivitetet, fillimin dhe përmbylljen e ndonjë projekti, në mënyrë që qytetari të informohet për rezultatet e punës dhe sukseset e Komunës.
		<b>Masa 4:</b> Informimi i mërgatës për arriturat e Komunës (ueb faqja, facebook, buletini, fletëpalosjet, broshurat) etj.
		<b>Masa 5:</b> Ngritja e kapaciteve të administratës komunale për informim të qytetarit.
		<b>Masa 6:</b> Ngritja e kapaciteve të ZMPI, për informim të qytetarëve.

<p><b>Prioriteti 2</b></p> <p>Mekanizmat ekzistues i dhënies së informacioneve tek qytetarët</p>	<p><b>Masa 1:</b> Rifreskimi permanent i ueb faqes me informata</p>
	<p><b>Masa 2:</b> Përdorimi i rrjeteve sociale për dhënien e informatave për qytetarët-publikun</p>
	<p><b>Masa 3:</b> Publikimi i informacioneve në tabela informuese.</p>
	<p><b>Masa 4:</b> Publikimi i buletinit, fletëpalosjeve, broshurave dhe panove.</p>
	<p><b>Masa 5:</b> Takime më qytetarë në hapësirën komunale dhe zonat rurale.</p>
<p><b>Prioriteti 3</b></p> <p>Krijimi i mekanizmave të rinj për dhënien e informacioneve</p>	<p><b>Masa 1:</b> Hartimi i kalendarit vjetor për aktivitetet e planifikuara</p>
	<p><b>Masa 2:</b> Krijimi i linjës telefonike ndihmëse për qytetarë</p>
	<p><b>Masa 3:</b> Fushata të përbashkëta informuese me organizatat jo qeveritare</p>
	<p><b>Masa 4:</b> Publikimi i materialeve promovuese të trashëgimisë natyrore-kulturore, turizem etj.</p>
<p><b>Prioriteti 4</b></p> <p>Bashkëpunimi me mediat e tjera</p>	<p><b>Masa 1:</b> Shpërndarja e informatave në mediat lokale, regjionale, kombetare përmes komunikatave (radio, gazeta, portale informuese)</p>
	<p><b>Masa 2:</b> Organizimi i emisioneve në radio dhe televizione</p>
<p><b>Prioriteti 5</b></p> <p>Informimi i qytetarëve për qasje në dokumentet publike</p>	<p><b>Masa 1:</b> Informimi i qytetarëve për shërbimet komunale përmes fletëpalosjeve, broshurave.</p>
	<p><b>Masa 2:</b> Publikimi i manualeve për qasje në dokumentet publike.</p>
	<p><b>Masa 3:</b> Publikimi i raporteve statistikore të shërbimeve të ofruara nga Komuna për qytetarët.</p>

**Projekti 1:**Objektivi 1: *Përmirësimi i mënyrave të informimit për qytetarë*Prioriteti 2: *Komunikim efektiv nga Komuna, më qellim që zhvillimet komunale të jenë sa më afër qytetarit*Prioriteti 3: *Mekanizmat ekzistues të dhënies së informacionit tek qytetarët*

Qëllimi i projektit		Rezultatet e pritura		Buxheti
Zhvillimet dhe aktivitetet e Komunës të jenë më afër qytetarëve		Qytetarë do të jenë më të informuar		
Kohëzgjatja e implementimit	Planifikimi i kostos financiare	Pergjegjësitë	Përfituesit	
	N/A	Kryetari Drejtoritë ZMPI	Të gjithë qytetarët	
Detyrat / Masat		Afati	Planifikimi i kostos financiare	Resurset
1. Vendimet dhe aktet e tjera				ZMPI
2. Vendosja e informacioneve, shërbimeve dhe aplikacioneve				Drejtoritë përkatëse dhe ZMPI
3. Drejtoritë komunale të ofrojnë informacione tek ZMPI për iniciativat, aktivitet për realizimin e projekteve në investimet kapitale, zhvillimin ekonomik, administratë, buxhet dhe financa, arsim, shëndetësi dhe aktivitetet e përbashkëta me organizatat joqeveritare, etj.				Drejtoritë përkatëse dhe ZMPI

4. Informimi i qytetareve për shërbimet komunale nëpërmjet fletëpalosjeve dhe broshurave.			Drejtoritë përkatëse dhe ZMPI
5. Ngritja e kapaciteteve të Administratës komunale për informim të qytetarëve.			Drejtoritë përkatëse dhe ZMPI
6. Ngritja e kapaciteteve të ZMPI për informim të qytetarëve			Drejtoritë përkatëse dhe ZMPI

Objektivi 1: *Përmirësimi i mënyrave të informimit për qytetarë*

7. Mirëmbajtja e ueb faqes komunale: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dokumentet komunale</li> <li>• Publikimi i planit vjetor të punës akteve te miratuara dhe procesverbaleve nga kuvendi i Komunës</li> <li>• Publikimi i të gjitha akteve të tjera komunale</li> <li>• Publikimi i informacioneve mbi shërbimet komunale</li> <li>• Publikimi i listës së shërbimeve të ofruara; mbi kushtet, çmimet dhe dokumentet e nevojshme për shërbimet e ofruara;</li> <li>• Formularët e të gjitha llojeve të kërkesave dhe parashtresave</li> <li>• Modelet e dokumenteve të plotësuara</li> <li>• Formularët e përshtypjeve dhe komentet e qytetarëve për shërbimet e ofruara.</li> </ul>			Drejtoritë përkatëse dhe ZMPI
8. Përdorim i rrjeteve sociale për dhënie të informacioneve për qytetarët - publikun (Facebook, YouTube) <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të gjitha informacionet rreth shërbimeve, lajmet, videot, të arriturat, të publikohen në facebook</li> <li>• Të publikohen, fletëpalosje, broshurat, posterët dhe publikimet tjera</li> </ul>	Janar-Dhjetor	N/A	Drejtoritë përkatëse dhe ZMPI

<p>9. Publikimi i informacioneve në tabela informuese</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Publikimi dhe rifreskimi i informacioneve në tabelat informuese, siç janë: shpallje, konkurse, poster, ftesa, etj</li> </ul>	Janar-Dhjetor	N/A	Drejtoritë përkatëse dhe ZMPI
<p>10. Publikimi i fletëpalosjeve, broshurave:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Publikimi i broshurave për informim në fusha me interes për qytetarët, siç janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>- broshura mbi shpenzimet dhe planifikimin e buxhetit të Komunës</li> <li>- broshura për qasje në dokumentet zyrtare</li> <li>- broshura të tjera, të cilat japin informacione konkrete për qytetarët, në fushën e shëndetësisë, arsimit, ekonomisë dhe investimeve kapitale;</li> </ul> </li> </ul>	Janar-Dhjetor	2, 500 €	Drejtoritë përkatëse dhe ZMPI

Projekti 2:

Objektivi 1: *Përmirësimi i mënyrave të informimit për qytetarë*

Prioriteti 3: Krijimi i mekanizmave efektiv për dhënien e informacioneve,

Prioriteti 4: Bashkëpunimi me mediat e tjera

Qëllimi i projektit	Rezultatet e pritura	Buxheti	
Krijimi i mekanizmave efektiv për dhënien e informacioneve Bashkëpunimi me mediat e tjera			
<b>Kohëzgjatja e implementimit</b>	Planifikimi i kostos financiare	Përgjegjësitë	Përfituesit
	N/A	Kryetari, Drejtoritë, ZMPI	Te gjithë qytetarët dhe grupet e tjera të interesit, OJQ dhe shoqata të tjera

Detyrat / Masat	Afati	Shpenzimet	Resurset
Vendosja e tabelave informuese në lokalitetet kryesore (qendrat e ish Bashkësive lokale)			Drejtoritë përkatëse, ZMPI dhe koordinatori i fshatrave
Hartimi i planit për mirëmbajtjen e tabelave informuese			Drejtoritë përkatëse dhe ZMPI
Krijimi i kalendarit vjetor për planifikim të aktiviteteve komunale			Drejtoritë përkatëse dhe ZMPI
Krijimi i linjës telefonike ndihmëse për qytetar			Drejtoritë përkatëse dhe ZMPI
Publikimi i buletinit çdo muaj, ku përfshihen aktivitetet e Komunës			Drejtoritë përkatëse dhe ZMPI
Publikimi i materialeve promovuese të trashëgimisë natyrore-kulturore, turizëm			Drejtoritë përkatëse dhe ZMPI
Shpërndarja e informatave në mediat lokale dhe nacionale përmes komunikatave (radio, televizione, gazeta, portale informuese)			Drejtoritë përkatëse dhe ZMPI
Organizimi i emisioneve në radio, televizione.			ZMPI dhe Drejtoritë përkatëse
Fushata të përbashkëta informuese me organizatat joqeveritare			Drejtoritë përkatëse dhe ZMPI

Objektivi 2: Krijimi i mënyrave për komunikim dhe ndikim në politikat publike.

Me këtë objektiv synojmë që me anë të mekanizmave të lehtësohet komunikimi me qytetarë dhe po ashtu të krijojmë mekanizma të rinj të komunikimit të ndërsjellët me qytetarë. Një gjë e tillë do të rrisë transparencën komunale në marrjen e vendimeve dhe në të njëjtën kohë vendimet komunale do të jenë më efektive dhe më të pranueshme për qytetarët.

Objektivat strategjike	Priorirte	Masat
<p><b>Objektivi 2:</b></p> <p><b>Krijimi i formave për komunikim dhe ndikim i qytetarëve në politikat publike</b></p>	<p><b>Prioriteti 1:</b></p> <p>Konsultime me qytetarë para marrjes së vendimeve me interes</p>	<p><b>Masa 1:</b></p> <p>Konsultime vjetore me biznese, grupe të ndryshme të interesit para aprovimit të Rregullores për bashkëpunimin e Komunës me fshatra vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës.</p> <p><b>Masa 2:</b></p> <p>Konsultim me grupe përkatëse të interesit para aprovimit të akteve, vendimeve dhe planeve komunale (shembull: strategjive dhe planeve zhvillimore, planeve urbanistike, planet për shërbime komunale, politikave rinore, politikave gjinore)</p>
	<p><b>Prioriteti 2:</b></p> <p>Konsultimi i qytetarëve para hartimit të projektbuxhetit të Komunës</p>	<p><b>Masa 1:</b></p> <p>Organizimi i dëgjimeve publike në fshatra dhe lokalitete</p> <p><b>Masa 2:</b></p> <p>Konsultime publike shtesë që i përgjigjen iniciativave dhe kërkesave të qytetarëve</p>

	<p>Prioriteti 3:</p> <p>Takime të rregullta me qytetarë</p>	<p><b>Masa 1:</b> Caktimi dhe publikimi i orarit të takimeve të rregullta me qytetarë ( Zyrën e Kryetarit, Kryesuesin e Kuvendit dhe drejtorët e Drejtorive).</p> <p><b>Masa 2:</b> Dita e diasporës</p> <p><b>Masa 3:</b> Përdorimi i ueb faqes komunale si mjet për marrjen e informacioneve nga qytetarët</p>
	<p>Prioriteti 4:</p> <p>Krijimi i mekanizmave te rinj për marrje të informacioneve nga qytetarët dhe grupet e ndryshme</p>	<p><b>Masa 1:</b> Përdorimi i ueb faqes komunale si mjet për marrjen e informacioneve nga qytetarët</p> <p><b>Masa 2 :</b> Lehtësimi i komunikimit nëpërmjet rrjeteve sociale (facebeook-ut)</p>